



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi Prilazimi / Prilazje Received / Delivery	31.12.2021	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Jedinstvo Org. / Unit	SKANSKICK	
Id. Prot. Id. Prot.	6480/2021	
Shtypja Protog. Appendix		
Sasia Kolicina Quantity		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.971/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrta i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2360/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.455/2019 të datës 09.08.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Llapi", Nr.238 në Prishtinë, kundër Vendimit KZKA Nr.11/2019 të datës 19.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.455/2019 e datës 09.08.2019 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KZKA Nr.11/2019 i datës 19.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

A r s y e t i m

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 03.05.2019, me datë 10.05.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar për Trashëgimi dhe Monumente të Infrastrukturës Rrugore" në Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit, por që nuk është për zgjedhur si kandidatë e suksesshëm në këtë pozitë.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 17.06.2019 ka bërë publikimin e njoftimit për kandidatin e suksesshëm. Ankuesja kundër këtij njoftimi më datë 19.06.2019 ka parashtruar

ankesë me Nr.2463/2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 19.07.2019 ka nxjerr Vendim me numër KZKA Nr.11/2019 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me numër KZKA Nr.11/2019 të datës 19.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.08.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3490/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.08.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kjo e fundit me datë 20.08.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.09.2019 ka njoftuar ankuesen lidhur me pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e datës 13.04.2020 për shkak të mungesës së kuorumit dhe të njëjtin e ka udhëzuar që t'i ndjek procedurën e përcaktuar me dispozitat e LKA-se. Ankuesja, kundër këtij njoftimi ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër A.nr.2360/19 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil që të shqyrtojë dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 09.08.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3490/2019 të datës 09.08.2019 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 19.06.2019 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; CV-në e ankueses; Diplomën me Nr.2883 të ankueses; Certifikatën e datës 01.04.2014; Vërtetimin e datës 28.05.2019 të ankueses; Referencën e shkurtit 2018 për ankuesen; Kontratën nga CDF për ankuesen; Kontratën e datës 09.03.2012 për ankuesen; Referencën e datës 28.10.2011 për ankuesen; Kontratën e Punës nga Lesna për ankuesen; Kontratën e punës për mësimdhënës e datës 04.11.2008 për ankuesen; Vendimin e datës 24.11.2011 për ankuesen; Kontratë për punësim e datës 23.05.2002 për ankuesen; Referenca e datës 09.03.2005; Formulari i vlerësimit të punës për konsulentët datë 17.04.2018; Certifikatën nga Gjykata Themelore në Prishtinë datë 21.06.2019; Kërkesën për fillimin e rekrutimit e datës 08.05.2019; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 08.05.2019; Konkursin për pozitën "Zyrtar për Trashëgimi dhe Monimente të Infrastrukturës Rrugore" e shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 10.05.2019; Autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike, të datës 03.05.2019; Formularin Form. MAP-SHCK-04 për Regjistrin e Aplikacioneve të pranuar; Vendimin me numër KZKA Nr.11/2019 të datës 19.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Procesverbalin e datës 19.07.2019 të

Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Formularin Form. MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë; Formularin Form. MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kritereve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin Form. MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin Form. MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin Form. MAP-SHCK-10 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formularin Form. MAP-SHCK-11 i raportit final i rekomandimit nga komisioni rekrutues datë 14.06.2019; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 17.06.2019; Testin me shkrim i datës 10.06.2019; Formulari i kërkesës për punësim i datës 23.05.2019 për ankuesen dhe kandidates M.Dibrani së bashku me dokumentet e përgatitjes profesionale dhe përvojës së punës; Vendimin me Nr. 1054/2019 të datës 30.05.2019 për formimin e Komisionit Përzgjedhës; dhe Përgjigjen në ankesë e datës 20.08.2019; Njoftimin e datës 23.09.2019 për ankuesen dhe Aktgjykimin A.nr.2360/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesja *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se kandidatja e përzgjedhur nuk është përzgjedhur sipas parimit të meritës pasi që është diskutabile nëse e njëjta ka kaluar pragun e testit me shkrim, kështu e tërë procedura është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses ka shqyrtuar provat e lëndës respektivisht testin me shkrim të datës 10.06.2019 të kandidatës dhe rrjedhimisht ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur M.Dibrani në testin me shkrim ka grumbulluar gjithsejtë 83.25 pikë, që nënkupton se ka marr pikët e nevojshme për t'iu nënshtruar testit me gojë siç përcaktohet me nenin 36 paragrafin 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *Kandidatët, të cilët kalojnë me sukses testimin me shkrim ose arrijnë të mbledhin së paku 50% të maksimumit të pikëve të përcaktuar nga KPSHC pranohen të hyjnë në testimin me gojë.*

Kolegji, po ashtu ka gjetur se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, vlerësimin e testit me shkrim dhe intervistës me gojë e ka bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi, sepse sipas provave të lëndës ankuesja ashtu sikurse edhe kandidatja e përzgjedhur kanë plotësuar kushtet e konkursit dhe përfshirja e tyre në listë të shkurtër është bërë në pajtim me nenin 28 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ndërsa në bazë të Formularit Form. MAP-SHCK-10 të Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve, kandidatja e përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me 86.19 pikë ndërsa ankuesja është renditur e dyta me 70.52 pikë, andaj në Shërbimin Civil emërohen kandidatët që kanë numërim më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë".* Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se në bazë të provave të lëndës nuk është vërejtur ndonjë veprim diskriminues ndaj ndonjë kandidati dhe në këtë kuptim procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9,

nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: "Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës" dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KZKA Nr.11/2019 të datës 19.07.2019, ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt ligjin material duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave duke arsyetuar vendimin në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.971/2021

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

